VENDIM
Nr. 34, datë 23.1.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM URBAN I SHESHIT NË FSHATIN SAMATICË", URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban i sheshit në fshatin Samaticë", Ura Vajgurore.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgurore.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "Tokë arë", me një vlerë të përgjithshme prej 206 000 (dyqind e gjashtë mijë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasurinë e llojit "Tokë arë", në masën prej 206 000 (dyqind e gjashtë mijë) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronari i përmendur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Ura Vajgurore.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajgurore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela paraprake e pronarit, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, që shpronësohen nga ralizimi i projektit "Rikualifikim urban i Sheshit në fshatin Samaticë", Ura Vajgurore

Çmimi për pasurinë e llojit "tokë arë", sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i Pasurisë	Sip. totale (m^2)	Sip. prekur (m^2)	Çmimi lekë/m^2 Njësi	Vlera në lekë	Konfirmuar ZRPP-ja Berat
1	Xhemal Dylja	Tokë arë	3256	16/37	1000	1000	206	206.000	po
	Vlera totale							**206.000**	